



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK

BULETINI JAVOR I SËMUNDSHMËRISË INFEKTIVE - ALERT

JAVA 17 22 - 28 Prill 2024

Për këtë periudhë, kanë raportuar 36 NJVKSH ose 100% (=36/36) e tyre

35 NJVKSH ose 97% (=35/36) e tyre kanë raportuar në platformën dixhitale SISI:

BERAT, BULQIZË, DEVOLL, DIBËR, DURRËS, ELBASAN, FIER, GJIROKASTËR, GRAMSH, KAVAJË, KOLONJË, KORÇË, KRUIË, KUÇOVË, KUKËS, KURBIN, LEZHË, LIBRAZHD, LUSHNJE, MALLAKASTËR, M. MADHE, MAT, MIRDITË, PEQIN, PËRMET, POGRADEC, PUKË, SARANDË, SHKODËR, SKRAPAR, TEPELENË, TIRANË, TROPOJË, VLORË.

Pa raportim brenda afatit, 1 NJVKSH ose 3% (=1/36) e tyre: HAS

NUMRI TOTAL I RASTEVE TË SINDROMAVE TË SURVEJANCËS "ALERT" NË JAVËN 17

	JAVA 17
DIARRE PA GJAK	1.142
DIARRE ME GJAK	0
INF. RESP. TE SIPËRME	8.166
INF. RESP. TE POSHTËME	3.453
RASH ME TEMPERATURË	13
VERDHEZA	0
ETHE E ZGJATUR E PASHPJEGUAR (> 3 JAVE)	0
ANOMALI KONGENITALE	0
KONJUKTIVIT AKUT TEK NEONATËT	0
Numri i Njësive Raportuese	417
% e Njësive Raportuese	95% (417/442)

Rash me temperaturë

Nga hetimi epidemiologjik dhe konsultat me mjekët e familjes, mjekun infeksionist dhe atë epidemiolog rastet e mëposhtëme nuk janë të dyshuar për fruth, rubeolë apo linë e majmunit, por për varicelë dhe dorë-këmbë-gojë:

Durrër – 1 rast

Fier – 6 raste


Gjirokastër – 2 raste

Pogradec – 1 rast


Tiranë – 3 raste

Infeksione respiratore

Trendi në kohë i Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme sipas javëve




Shpërndarja e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme sipas Grup-moshave




Prirja në kohë e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme paraqet rënie në javën 17 krahasuar me javën paraardhëse, java 16.

Diarre pa gjak

Trendi në kohë i Diarreve pa Gjak sipas javëve




Shpërndarja e Diarreve pa Gjak sipas Grup-moshave




Prirja në kohë e “Diarreve pa gjak” paraqitet e qëndrueshme në javën 17 krahasuar me javën paraardhëse, java 16.

Krahasimi i aktivitetit të “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas sezoneve (javët 40 – 20) dhe Pragu Epidemik. Raste/100.000




Prirja e “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” në javët 10 – 17 të viteve 2023 dhe 2024. Numri i rasteve.




Në javën 17 të vitit 2024 vërehet prirje në rënie e numrit të infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme.


Frekuenca e “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas grupmoshës. Incidenca (raste/10.000)



Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas NJVKSH në javën 16 dhe 17 / 2024. Incidenca (raste/10.000)




Prirja e “Diarreve pa Gjak” në javët në javët 10 - 17 të viteve 2023 dhe 2024. Numri i rasteve.



Në javën 17 të vitit 2024 vërehet e prirje qëndrueshme e numrit të rasteve “Diarre pa gjak”.

**Frekuenca e hasjes së “Diarreve pa gjak” sipas NJVKSH në javën 16 dhe 17 / 2024.
Incidenca (raste/10.000)**



Nga komunikimi me NJVKSH shumica e rasteve janë raportuar nga Urgjenca e Spitaleve dhe janë të shpërndara, pa grumbullime dhe lidhje epidemiologjike ndërmjet tyre.

Ngjarje kombëtare

1. *Situata epidemiologjike e fruthit*

Theksojmë se nuk ka asnjë ndryshim në situaten epidemiologjike të fruthit në vend për javën e 17 krahasuar me një javë më parë.

- Për periudhën Janar – 29 prill 2024 janë testuar 179 raste të dyshuar me fruth nga të cilët janë konfirmuar 38 (21.2%) raste me Fruth.
- Nga keto 35 raste janë konfirmuar në laboratorin kombëtar të referencës të virologjisë në ISHP dhe 3 raste janë konfirmuar sipas perkufizimit të rastit mbeshtetur në shenjat klinike dhe epidemiologjike.
- Incidenca e sëmundjes në vend është 1.4 raste/100 000 banorë.
- Rastet i perkasin moshes nga 0-38 vjec (mediana 5 vjec).
- Numri më i lartë i perkët grupmoshes 5-9 vjec me 31.6% të totalit të rasteve të konfirmuar.
- Incidenca më e lartë është në grupmoshën 2-4 vjec me 14 raste/100 000 banorë.
- Nga 38 rastet e konfirmuar 21 (55.3%) prej tyre janë shtruar në spital dhe 17 raste (44.7%) kanë qëndruar në kushte shtëpie si edhe 22 raste janë të pavaksinuar (58%) dhe 16 raste (42%) janë të vaksinuar me të paktën një dozë vaksine.
- Numri më i lartë i rasteve i perkët Tiranës 25 raste ose 65.8% e totalit, ndërsa incidencën më të lartë e ka Durresi me 4.7 raste/100 000 banorë.

Ngjarje Ndërkombëtare

2. *Një rast i hershëm i infeksionit të virusit të Nilit Perëndimor në një provincë në Spanjë*

- Një rast njerëzor autokton i infeksionit me virusin e Nilit Perëndimor (WNV) me datën e fillimit të simptomave në fillim të marsit 2024 u raportua nga Spanja.
- Rasti ka të ngjarë të jetë infektuar në provincën e Seviljes, Andaluzi.

3. *Kolera – Komore dhe Majotë – 2024*

- Sipas mediave, më 26 prill, Agjencia Rajonale e Shëndetit në Mayotte raportoi tre rastet e para autoktone të kolerës. Që nga 18 marsi dhe deri më 26 prill 2024, janë raportuar 13 raste të kolerës dhe asnjë vdekje.
- Duke pasur parasysh identifikimin e tre rasteve të para autoktone në Mayotte, shpërthimin e vazhdueshëm në Komore dhe lëvizjen e shpeshtë të njerëzve nga Komoret në Mayotte, gjasat për transmetim të mëtejshëm nga komuniteti dhe për rrjedhojë rreziku i përgjithshëm i kolerës për popullsinë në Mayotte mbetet i lartë.
- Në Komore, që nga përditësimi i fundit i disponueshëm më 18 prill dhe që nga 24 prilli, janë raportuar 620 raste të reja të kolerës dhe 16 vdekje të reja. Deri më 24 prill 2024, në vend janë raportuar 2 584 raste të konfirmuara të kolerës dhe 61 vdekje.